



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Doretuar Primijsno/Prodato Received/Delivety		19. 08 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANSHCK	4823/2022		1/5	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.605/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.605/2022 të datës 07.07.2022 të parashtruar nga ankuesja ne adresë banimi

kundër Vendimit KA.Nr.19.2021 të datës 10.06.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 19.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. *Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.605/2022 e datës 07.07.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. *Mbetet në fuqi* Vendimi KA.Nr.19.2021 i datës 10.06.2022 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial.

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 07.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3973/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.Nr.19.2021 të datës 10.06.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljeve e proceduarave të rekrutimit, jo objektivitet të komisionit dhe jo transparencës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.07.2022 proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të organi i punësimit/Këshilli Prokurorial i Kosovës, ndërsa ky i fundit

më datë 20.07.2022 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3973/2022 e datës 07.07.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.Nr.19.2021 të datës 10.06.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial; Zarin e datës 05.07.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 13.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 20.07.2022; Konkursin e datës 30.03.2022 për pozitën Referent i Lartë në Prokurorinë Themelore në Prishtinë; Vendimin me Nr.641/2022 i datës 19.04.2022 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Njoftimin për kandidatët të përzgjedhur në listën e ngushtë i datës 22.04.2022; Formularin për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë i datës 21.04.2022; Listën përfundimtare të përzgjedhës së listës së ngushtë e datës 21.04.2022; Formularin e përmbledhjes individuale të listës së ngushtë i datës 21.04.2022; Deklaratat për moskëzimin e konfliktit të interesit e datës 21.04.2022; Regjistrin për ardhjen në testin me shkrim i datës 22.04.2022; Regjistrin për ardhjen në intervistë i datës 06.05.2022; Listën përfundimtare të përzgjedhjes të testit me shkrim i datës 04.05.2022; Formularin e përmbledhjes së vlerësimeve individuale të testit me shkrim dhe intervistës i datës 10.05.2022; Formularin përmbledhjes të vlerësimeve individuale të intervistës i datës 10.05.2022; Formularin e vlerësimit individual në intervistë me gojë i datës 10.05.2022; Formularin për vlerësimin individual përfundimtar për kandidatët për vendin e punë për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 10.05.2022 për kandidatët

Testin me shkrim i kandidatës ankueses; Aplikacionin për punësim të kandidatës e datës 09.04.2022, Certifikatën e Gjykatës Themelore në Prishtinë e datës 08.11.2021, Diplomën e lëshuar nga Kolegji Fama dhe Arbëri, Vërtetim punësimi i datës 20.01.2020, 06.03.2017, Kontrate e datës 27.01.2020, 04.10.2021, Referencën e datës 10.03.2017, Rekomandimin e datës 31.03.2014; Aplikacionin për punësim të ankueses e datës 05.04.2022, Diplomën me Nr.1716 e datës 10.12.2012, Certifikatën e datës 05.01.2017, Rekomandim GJ.A.nr.430/2016 i datës 06.12.2016, Kontratë Pune e datës 05.01.2017, Rekomandim i datës 04.04.2002, Vërtetim Vr.Nr.002/2022 i datës 04.04.2022, Pasqyrën e llogarisë nga TRUSTI, Certifikatë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega Skenderaj e datës 16.11.2021; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 10.05.2022; njoftim për përzgjedhjen përfundimtare i datës 12.05.2022; Rekomandimin për emërim i datës 12.05.2022; Ankesën e datës 20.05.2022 nga ankuesja për Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Procesverbalin e takimit të mbajtur nga Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së është e pabazuar ankesa e ankueses **sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rezulton së Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 30.03.2022 ka shpallur Konkursin publik me nr.reference KPA/ZKPSH/PA/PRSK/PTH/POZ-003 për pozitën e punës "Referent i Lartë" në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja dhe së e

njëta është përfshirë në të gjitha fazat e kësaj procedure rekrutimi. Rrjedhimisht sipas shkresave të lëndës Kolegji gjen së në konkursin në fjalë, kanë aplikuar gjithsej 16 kandidatë, në listën e ngushtë të datës 22.04.2022 janë përfshirë 9 kandidatë, testit me shkrim i mbajtur me datë 27.04.2022 i janë nënshtruar 9 kandidatë, ku 5 nga kandidatët kanë arritur pikët e kalueshmërisë së testit dhe së të njëjtit kanë marrë pjesë edhe në intervistën më gojë të datës 10.05.2022, ndërsa sipas Përmbledhjes së Vlerësimeve Individuale të Komisionit të Pranimit të datës 10.05.2022, kandidatja është vlerësuar si kandidatja më më shumë pikë gjithsej 80.8 pikë, ndërsa ankuesja si kandidatja e tretë më gjithsej 61.0 pikë.

Ankuesja e pakënaqur me vlerësimin përfundimtar, më datë 20.05.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, i cili me Vendimin KA.Nr.19.2021 të datës 10.06.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses duke e lënë në fuqi Njoftimin e datës 12.05.2022 të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokuroria të Kosovës për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit për pozitën Referent i Lart në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon që këtë konkurs ka pasur shkelje procedurale sepse nuk janë publikuar pikët e testit me shkrim për faktin që kam kaluar këtë test me mbi 95%, ndërsa komisioni në mënyrë jo transparente ka punësuar persona që paraprakisht kanë qenë të punësuar në KPK, kështu që nuk është shikuar përvoja e punës, andaj KPK duhet të ketë parasysh kandidatët që kanë diplomuar më herët dhe të krijoj njëfarë rendi të punësimit, po ashtu edhe Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 86 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të vendosjes së drejt dhe të ligjshme lidhur me këtë çështje juridike-administrative, ex officio ka shqyrtuar në tërësi procedurën e rekrutimit sipas Konkursit me numër reference KPA/ZKPSH/PA/PRSK/PTH/POZ-003 për pozitën e punës "Referent i Lartë" në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, dhe rrjedhimisht ka konstatuar së shpallja e konkursit ka qenë në pajtim me nenin 16 dhe 17 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Komisioni Përzgjedhës i themeluar sipas Vendimit DPSKPK/144/2022 të datës 19.05.2022 është në përbërje të përcaktuar me nenin 7 të po kësaj Rregullore dhe se po ashtu Kolegji lidhur me procedurën e vlerësimit-testimi me shkrim dhe gojë nuk ka gjetur ndonjë shkelje procedurale përkatësisht në kuptim të vlerësimit të testit me shkrim të ankueses siç pretendohet nga e njëjta, Kolegji me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetoj se Komisioni Përzgjedhës nuk ka bërë vlerësim të drejt të testit të ankueses. Për me tepër, Kolegji nga analizimi i shkresave të lëndës dhe duke marrë parasysh pretendimin ankimor të ankueses ka gjetur se ka pas tejkalim të afatit të procedurës së testimit siç është përcaktuar me nenin 32 paragrafi 1 të Rregullores Nr 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe së me asnjë provë nuk dëshmohet së kandidatet të jenë njoftuar me rezultatin e përgjithshme të vlerësimit siç kërkohet me nenin 41 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, mirëpo Kolegji vlerëson së lëshimet e tilla procedurale nuk kanë cenuar ne asnjë formë ligjshmërinë e procedurës së rekrutimit dhe nuk kanë sjellë ekzistimin e rrethanave të diskriminimit apo mos trajtimit të barabartë të kandidateve përfshirë edhe ankuesen.

Në bazë të konkursit me numër reference KPA/ZKPSH/PA/PRSK/PTH/POZ-003 të shpallur më datë 30.03.2022 për pozitën Referent i Lartë për Prokurorinë Themelore në Prishtinë, si kritere të përcaktuara për këtë pozitë kanë qenë: *Diplomë universitare, Fakulteti Juridik, Administratë Publike dhe Shkenca Sociale dhe së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale*, andaj nisur nga këto kërkesa, Kolegji nga analizimi i dokumentacionit të aplikimit të kandidatës së përzgjedhur ka konstatuar së e njëjta sipas Diplomës me nr.440/009 të datës 26.10.2009 të lëshuar nga Kolegji "FAMA" ka përfunduar studimet themelore me datë 24.09.2009 në Kriminialistikë dhe ka marr titullin Bachelor i Arteve në Kriminialistikë, sipas Diplomës të lëshuar nga Kolegji "ARBËRI", e njëjta ka përfunduar studimet themelore në programin Juridik i Përgjithshëm, sipas Diplomës me numër 378/518 të datës 19.05.2016 të lëshuar nga Kolegji "Fama" kandidatja ka përfunduar studimet Master i Arteve në studimet e shkencave të sigurisë, kurse lidhur me përvojën e punës ka prezantuar: Vërtetimin e datës 06.03.2017 të lëshuar nga menaxherja e lartë e financave dhe administratës së Programit të USAID-it "Contract Law Enforcement Program" me të cilën dëshmohet se e njëjta ka punuar në Programin për Përmbarim dhe Legjislacion Komercial USAID/CLE, dhe atë Praktikante prej datës 15.07.2013 deri 14.07.2014 e angazhuar në iniciativën për zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara në gjykatat e Kosovës, Zyrtare për Zvogëlimin e lëndëve përmbaruese prej datës 15.07.2014 deri me 27.01.2015, dhe Zëvendës Kordinatore për zvogëlimin e lëndëve të grumbulluara në gjykatat e Kosovës prej 28.01.2015 deri me 06.05.2017; Vërtetimin KOS00013/VT-01-2020 janar XX 2020 me të cilin është vërtetuar së V. ka qenë e punësuar në IMG si Z Udhëheqëse e Ekipit/Trajnere për Projektin "Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve TIK/SMIL" nga data 01.06.2017 deri 30.09.2019, Zyrtare Ligjore nga data 01.10.2019 deri 30.06.2020 dhe sipas Kontratës së shërbimit e njëjta ka punuar në këtë projekt nga data 04.10.2021 deri 31.12.2021 si trajnere. Ndërsa ankuesja sipas dëshmime të prezantuara me rastin e aplikimit posedon: Diplomën me Nr.1716 të datës 10.12.2012 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës më të cilën vërtetohet së ka të përfunduara Fakultetin Juridik me datë 12.09.2012 dhe ka marrë titullin Jurist i Diplomuar-Bachelor, kurse lidhur me përvojën e punës posedon: Certifikatën e datës 05.01.2017 të lëshuar u.d Kryetari Gjykatës Themelore në Mitrovicë me të cilën dëshmohet se ankuesja nga data 05.01.2016 deri më datës 31.12.2016 ka kryer praktikën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega Skenderaj, Vërtetimin Vr.Nr.002/2022 të datës 04.04.2022 të lëshuar nga Avokat me të cilën dëshmohet së ankuesja është e punësuar në Zyrën e avokatit që nga data 05.01.2017 dhe ende vazhdon të ushtroj këtë detyrë, ku si dëshmi përcjellës lidhur me këtë përvojë punë ka ofruar edhe Kontratën e Punës Nr.evid.001/17 të datës 05.01.2017, si dhe Pasqyrën e Trustit të datës 04.04.2022. Kështu që nisur nga gjendja e fakteve si me lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankuesja dhe kandidatja e përzgjedhur kanë plotësuar kushtet e arsimit dhe përvojës së punës, mirëpo në bazë vlerësimit përfundimtar të Komisionit përzgjedhës kandidatja e përzgjedhur është vlerësuar si kandidatja me më shumë pikë gjithsej me 80.8% të pikëve, ndërsa ankuesja si kandidatja e tretë me gjithsej 61.0% pikë, dhe si rrjedhojë Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku parashihet se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë*".

Andaj, mbi bazën e të gjeturave si më lart, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.Nr.19.2021 të datës 10.06.2022 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe e ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, kështu që pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.605/2022

Avdy BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

